



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:096361

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610808

C.nr.1294/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditëses KS P., me seli në Prishtinë, rruga “E.L.” Ob.-, lagja Arbëria, kundër të paditurit B. (I.) S., rruga K.Z., në Ferizaj, tani me adresë të panjohur në S., për regresin e dëmit, jashtë seancës me 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditëses KS P., me seli në Prishtinë j, kundër të paditurit B.(I.) S., rruga K.Z., në Ferizaj, për regresin e dëmit.

A r s y e t i m i

Paditësja ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 13.08.2020, kundër të paditurit, për regresim të dëmit.

Gjykata me 23.04.2024, ka pranuar parashtresën nga i paditësja përmes email-it zyrtar, me të cilën e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë këtë padi.

Andaj, duhet konsideruar se padia në këtë çështje është tërhequr, për arsyen e theksuar më lartë, gjykata parashtresën për tërheqjen e padisë, e ka aprovuar pa shqyrtim gjyqësor të çështjes i njëjti ka qenë i pa nevojshëm, duke u mbështetur në nenin 261.1 të LPK-së merr aktvendim me të cilin **konstatohet se është tërhequr padia.**

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1294/20, me datën 23.04.2024

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa – bazuar në nenin 261 par .4 i LPK-së.